




Për: **Paneli Zgjedhor për Parashtresa dhe Ankesa – PZAP**

Rr. Migjeni pn., 10000 Prishtinë

Kosovë

Email: Info@pzap-ks.org

Nga: **Lëvizja VETËVENDOSJE! – Qendra Gjermani**

Përfaqësuar nga: Fahri Beqa

Marmaraweg 33

12109 Berlin

Gjermani

Tel. +4915143309303

Email: fbeqa@yahoo.com

vetevendosje.de@gmail.com

Datë: 31 gusht 2024

Duke u mbështetur në dispozitat e nenit 96 par.8 dhe Nenit 119, par. 5 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), si dhe Nenit 9, par. 4, nën-par. 1.11, Nenit 5, 6, par. 2 të Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave (RrPPVA), subjekti politik Lëvizja VETËVENDOSJE! (**Ankuesi**) parashtroi këtë:

ANKESË

1. Me datë 29 gusht 2024, në mbledhjen e 46 për vitin 2024, KQZ ka marrë Vendim për Miratimin e Listës së Qendrave të Votimit Jashtë Kosovës, Numrin e Vendvotimeve dhe Numrin Maksimal të Votuesve, me Nr. 01/1305-2024 (Shih **Prova 1**: Vendimi i bashkëngjitur në këtë Ankesë).
2. Ky Vendim ende nuk është publikuar në Web-fagen e KQZ deri më 30.08.2024, ora 22.06h (Shih **Prova 2**: screenshot i bërë nga: <https://kqz-ks.org/legjislacioni/vendimet-e-kqz-se-2024/>, bashkëngjitur në këtë Ankesë). Vendimi është siguruar më 30.08.2024, në ora 17.20h.
3. Në pikën I të Vendimit thuhet: “*Miratohet lista e qendrave të votimit jashtë Kosovës, numri i vendvotimeve dhe numri maksimal i votuesve, për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikën së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025.*” Ndërsa në pikën II thuhet: “Lista si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.” (Shih **Prova 3**: “*Qendrat e votimit në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës, për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës që mbahen me 9 shkurt 2025*”, bashkëngjitur në këtë Ankesë).
4. Bazuar në Nenin 9, par. 4 në lidhje me par. 1 të RrPPVA, në lidhje me ankesat ndaj vendimeve të KQZ, megjithëse nuk është specifikuar shprehimisht e drejta e kundërshtimit me ankesë të caktimit të qendrave të votimit, numrit të vendvotimeve dhe kufizimit të numrit maksimal të votuesve jashtë Kosovës, duke e konsideruar si çështje të rëndësishme parësore, për shkak të karakterit kufizues të të drejtës për shprehjen e vullnetit politik të qytetarëve – të votës, Lëvizja Vetëvendosje (Ankuesi) parashtroi ankesë brenda afatit ligjor. Ankuesi pretendon se Vendimi i KQZ është ligjërish i paqëndrueshëm dhe i paarsyetuar, praktikisht i paarsyeshëm dhe faktikisht diskriminues.
5. Në mbështetje të kësaj për sa u cek më lartë, bazuar në Nenin 119, par. 5 të LZP, duke pasur parasysh rëndësinë e çështjes së ngritur, për të “*parandaluar një padrejtësi serioze*”, duke e konsideruar si çështje “*rreptësisht të domosdoshme*”, e cila bie “*nën juridiksionin e tij*”, Ankuesi kërkon nga PZAP që të shqyrtojë këtë çështje.
6. Bazuar në Nenin 96, par. 8 i LZP, i cili citon: “*KQZ-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, vlerëson hapësirat fizike për secilën përfaqësi diplomatike dhe, në përputhje me kriteret e përcaktuara, merr vendim për numrin e vendvotimeve dhe për numrin e votuesve për secilën*

përfaqësi diplomatike. Jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e shpalljes së datës së zgjedhjeve, KQZ kërkon nga MPJ, listën e të gjitha përfaqësive diplomatike, bashkë me detajet e nevojshme mbi hapësirën e objekteve. Ministria e Punëve të Jashtme obligohet që t'i ofrojë KQZ-së të gjitha informacionet e kërkuara brenda tre (3) ditë, nga dita e pranimit të kërkesës. MPJ përshtat hapësirat e objekteve të përfaqësive diplomatike në vendvotime sipas kriterëve të përcaktuara nga KQZ.”

7. Rrjedhimisht, në hapin e parë, vlerësimin e hapësirave fizike për secilën përfaqësi diplomatike, KQZ e bën në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ). Dhe, vetëm në hapin e dytë, KQZ, **po ashtu në bashkëpunim me MPJ**, merr vendim për numrin e vendvotimeve dhe të votuesve. Pikërisht me këtë Vendim KQZ ka bërë gabim në hapa, për arsye se, duke e konsideruar bashkëpunimin vetëm sa për sy e faqe, nuk ka marrë parasysh veprimet dhe zotimet ligjore të MPJ në këtë drejtim dhe rrjedhimisht ka marrë vendim në mënyrë të njëanshme dhe arbitrar.
8. Në të vërtetë, sipas kërkesës ligjore të Nenit 96, par. 8 të LZP, MPJ brenda afateve ligjore i ka dërguar KQZ përmes emailit, por edhe në takimet fizike, listën e qendrave të votimit me numrin e votuesve që mund të votojnë në ato qendra të votimit jashtë Kosovës (Shih **Prova 4**: 4 emaila të dërguar nga MPJ më 28 gusht 2024 në adresë të KQZ, bashkëngjitur në Ankesë). MPJ, brenda afatit të paraparë ligjor sipas par. 8 të Nenit 96 të LZP, MPJ është përgjigjur në kërkesën e KQZ (Shih **Prova 7**: Email i dërguar nga KQZ në MPJD më 26 gusht 2024).
9. Krahas kësaj, MPJ përmes emailit, më 26 gusht 2024 ka përcjellur në KQZ edhe listën e të gjitha përfaqësive diplomatike të Republikës së Kosovës dhe numrin e mundshëm të votuesve që mund të votojnë në hapësirat e këtyre përfaqësive diplomatike (Shih **Prova 5**: MPJD - Propozimlista për KQZ), të cilat, bazuar në kompetencat dhe të drejtat që rrjedhin sipas të Drejtës Ndërkombëtare (Konventa e Vienës për Marrëdhëniet Diplomatike e vitit 1961), garanton se mund të sigurohen nga MPJ brenda afateve të përshtatshme ligjore, si dhe një pasqyrë të të gjitha përfaqësive diplomatike të Republikës së Kosovës (Shih **Prova 6**: Lista e profilit teknik të përgjithshëm të objekteve).
10. Nisur nga këto fakte konkrete, shihet qartë se nxjerrja e Vendimit nga KQZ **nuk është bërë në bashkëpunim me MPJ** ashtu siç kërkon Neni 96, par. 8 i LZP “KQZ-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, vlerëson hapësirat fizike për secilën përfaqësi diplomatike dhe, në përputhje me kriteret

e përcaktuara, merr vendim për numrin e vendvotimeve dhe për numrin e votuesve për secilën përfaqësi diplomatike.” Pra, KQZ vetë as e ka bërë “vlerësimin e hapësirave fizike”, as e ka “marrë vendimin për numrin e vendvotimeve dhe për numrin e votuesve për secilën përfaqësi diplomatike”. KQZ as e ka bërë vetë këtë, dhe as në bashkëpunim me MPJ, duke mos ia falur besimin MPJ për kryerjen e obligimeve ligjore. Prandaj, Vendimi i KQZ është arbitrar, i kundërligjshëm, i paarsyetuar dhe diskriminues në raport me votuesit jashtë Kosovës.

11. Përfundimisht, e drejta e votës është e drejtë e garantuar me Nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Askush, përfshirë edhe KQZ, që është e obliguar ligjërisht sikurse të gjitha institucionet e tjera shtetërore, të “mbështesë mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.”, nuk ka të drejtë të kufizojë këtë të drejtë, përveç kur kjo kufizohet me vendim gjyqësor.
12. Të gjitha veprimet dhe procedurat e institucioneve shtetërore duhet të jenë të bazuara në ligj dhe të arsyetuara sipas ligjit. Me Vendimin e datës 29 gusht 2024, KQZ nuk e ka përfillur këtë postulat kushtetues dhe ligjor. Rrjedhimisht, duke u nisur nga sa u dëshmuar në paragrafët e mësipërm të kësaj Ankese, Vendimi i KQZ qartazi përbën veprim kundërligjor dhe kundërkushtetues.
13. Prandaj, kërkojmë nga PZAP, që në përputhje me pretendimet e shprehura më lartë lidhur me natyrën e kësaj çështjeje, të marrë këtë:

V E N D I M

- I. Të shpallë të pavlefshëm Vendimin Nr. 01/1305-2024 të datës 29.08.2024, dhe të urdhërojë KQZ që të veprojë sipas Nenit 96, par. 8 i LZP, duke hequr kufizimin e tillë të numrit maksimal të votuesve në qendrat e votimit jashtë Kosovës, si dhe të nxjerrë Vendim meritore, të arsyetuar në lidhje me këtë çështje në bashkëpunim me MPJD.


Londër,
31 gusht 2024

Lëvizja Vetëvendosje - Britani
Qendrim Krasniqi

Shtojcat:

1. **Prova 1:** Vendimi i KQZ, 29.08.2024
2. **Prova 2:** screenshot i bërë nga: <https://kqz-ks.org/legjislacioni/vendimet-e-kqz-se-2024/>, 30.08.2024, ora 22.06h
3. **Prova 3:** Qendrat e votimit në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës, për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës që mbahen me 9 shkurt 2025
4. **Prova 4:** 4 emaila të dërguar nga MPJ më 28. gusht 2024 në adresë të KQZ
5. **Prova 5:** MPJD - Propozimlista për KQZ
6. **Prova 6:** Lista e profilit teknik të përgjithshëm të objekteve
7. **Prova 7:** Email i dërguar nga KQZ në MPJD më 26 gusht 2024

1. Prova 1: Vendimi i KQZ, 29.08.2024



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me amandamentet e dhëna me nenin 63 nënin 96 paragrafi 6 të Ligjit Nr.08/L-228; për zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 12 të Rregullores Zgjedhore Nr.17/2024, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 29.08.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Listës së Qendrave të Votimit Jashtë Kosovës, Numrin e Vendvotimeve dhe Numrin Maksimal të Votuesve

- I. Miratohet lista e qendrave të votimit jashtë Kosovës, numri i vendvotimeve dhe numri maksimal i votuesve, për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025.
- II. Lista si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Ohëgohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyj në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 29.08.2024


Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik R. Gashi



2. Prova 2: screenshot i bërë nga: <https://kqz-ks.org/legjislacioni/vendimet-e-kqz-se-2024/>, 30.08.2024, ora 22.06h



3. Prova 3: Qendrat e votimit në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës, për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës që mbahen me 9 shkurt 2025

Qendrat e votimit në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës që mbahen me 9 shkurt 2025						
Kodi i qendrës së votimi	Shteti	Qyteti	Përfaqësia diplomatike	Adresa	Numri i vendvotimeve	Numri maksimal i votuesve
AU01	Australi	O'Malley	Ambasada e Republikës së Kosovës	13 Culgoa Circuit O' Malley ACT 2606 PO Box 4128, ACT 2604	1	1000
AT01	Austri	Vjenë	Ambasada e Republikës së Kosovës	Geldengasse 2/15, Wien 1040 Wien	1	1000
BE01	Belgjikë	Bruksel	Ambasada e Republikës së Kosovës	Avenue Roger Vandendriessche 38, 1150 Bruksel	2	2000
CZ01	Çeki	Pragë	Ambasada e Republikës së Kosovës	Tržitzě 366/13, 118 00, Praha 1	1	1000
DK01	Danimarkë	Kopenhage	Konsullata e Republikës së Kosovës	Frederiksholms Kanal 4 st th, 1220 København K Danimarkë	1	1000
FR01	Francë	Strasburg	Konsullata e Republikës së Kosovës	8 Avenue d'Alsace, Strasbourg, France, 67000	1	1000
FR02	Francë	Paris	Konsullata e Republikës së Kosovës	7 Rue de Monceau, 75008 Paris, France	1	1000
DE01	Gjermani	Düsseldorf	Konsullata e Republikës së Kosovës	Bilker Str. 29, 40215 Düsseldorf	3	3000
DE02	Gjermani	München	Konsullata e Republikës së Kosovës	Albert-Schweitzer-Str. 62 81735 München	2	2000
DE03	Gjermani	Berlin	Ambasada e Republikës së Kosovës	Koenigsallee 20A/20B, 14193 Berlin	2	2000
DE04	Gjermani	Hamburg	Konsullata e Republikës së Kosovës	Rothenbaumchaussee 133, 20149 Hamburg	2	2000
DE05	Gjermani	Stuttgart	Konsullata e Republikës së Kosovës	Johannesstrasse 47/b70176 Stuttgart	2	2000
DE06	Gjermani	Frankfurt	Konsullata e Republikës së Kosovës	Falkensteiner Str. 77, 60322 Frankfurt am Main	2	2000
NL01	Holandë	Hagë	Konsullata e Republikës së Kosovës	Koningsinnegracht 44, 2514 AD Den Haag, Netherlands	1	1000
HU01	Hungari	Budapest	Ambasada e Republikës së Kosovës	H-1051 Budapest, Nádor utca 36/2./1.	1	1000
ITQ1	Itali	Romë	Ambasada e Republikës së Kosovës	Via Tolmino, 12, 00198 Romë, Itali	1	1000
ITQ2	Itali	Milano	Konsullata e Republikës së Kosovës	Via San Martino, 10, 20122 Milano MI	1	1000
CA01	Kanada	Ottawa	Ambasada e Republikës së Kosovës	470 Somerset St W, Ontario, K1R 5J8 OTTAWA	1	1000
CA02	Kanada	Toronto	Konsullata e Republikës së Kosovës	Suite 400-150 Eglinton Avenue East, Toronto ON M4P 1E8	1	1000
HR01	Kroaci	Zagreb	Ambasada e Republikës së Kosovës	Antuna Nemčića 7/2 kat; Hercegovačka 117; 10 000 Zagreb	1	1000
ME01	Mali Zi	Podgoricë	Ambasada e Republikës së Kosovës	Sejk Zaid 2, The Capital Plaza, kati V 81000 Podgorica, Montenegro	1	1000
MK01	Maqedoni e Veriut	Shkup	Ambasada e Republikës së Kosovës	At. Samoilova 136/1000 Shkup, Maqedonia e Veriut	1	1000
GB01	Mbretëria Bashkuar	London	Ambasada e Republikës së Kosovës	8 John Street, London, WC1N 2EB, UK	2	2000
NO01	Norvegji	Oslo	Ambasada e Republikës së Kosovës	Cdibjærnsens gate 4 0256 Oslo Norway	1	1000
US01	SHBA	New York	Konsullata e Republikës së Kosovës	801 2nd Avenue, Suite 301, New York, NY 10817	2	2000
US02	SHBA	Washington	Ambasada e Republikës së Kosovës	3612 Massachusetts Ave. NW, Washington D.C. 20007	1	1000
US03	SHBA	Iowa	Konsullata e Republikës së Kosovës	Court Avenue 309, Suite 223, Des Moines IA, 50309	1	1000
AL01	Shqipëri	Tiranë	Ambasada e Republikës së Kosovës	Rr. Ukraina e Libë Vila Nr.06 1001	1	1000
SI01	Slloveni	Lubjanë	Ambasada e Republikës së Kosovës	Tivolska cesta 48, 1000 Lubjanë	1	1000
SE01	Sueci	Stokholm	Ambasada e Republikës së Kosovës	Birger Jarls gatån 35, 111 45 Stockholm P.O. Box 3643 103 59 Stockholm	2	2000
TR01	Turqi	Stamboll	Konsullata e Republikës së Kosovës	Vali Konagi Cad.No 74 D-3 Nisantasi,Istanbul-Turkiye, 34365	1	1000
TR02	Turqi	Ankara	Ambasada e Republikës së Kosovës	Hirfanli Sokak 14/02 Gaziosmanpasa, Cankaya; Ankara; 6700	1	1000
CH01	Zvicër	Bern	Ambasada e Republikës së Kosovës	Zähringerstrasse 25, 3012 Bern	1	1000
CH02	Zvicër	Genevë	Konsullata e Republikës së Kosovës	Rue de Lausanne 63, 1202 Genève	1	1000
CH03	Zvicër	Cyrilli	Konsullata e Republikës së Kosovës	Eugen-Huber-Strasse 19A, 8048 Zürich	2	2000

4. Prova 4: 4 emaila të dërguar nga MPJ më 28.gusht 2024 në adresë të KQZ

From: Adenit Hoti <adenit.hoti@rks-gov.net>

Date: August 28, 2024 at 12:58:57 GMT+2

To: Burim Ahmetaj <Burim.Ahmetaj@kqz-ks.org>, Kreshnik Spahiu <Kreshnik.Spahiu@kqz-ks.org>

Cc: Kreshnik Radoniqi <Kreshnik.Radoniqi@kqz-ks.org>, Ilir Muçaj <Ilir.Mucaj@rks-gov.net>, Triera Kasumi <Triera.Kasumi@rks-gov.net>, Zyra e Sekretarit në MPJD <zsp.mpjd@rks-gov.net>, Lirik Krasniqi <Lirik.Krasniqi@kqz-ks.org>

Subject: [MPJD] Propozim-lista për qendrat e votimit/ numrin e votuesve jashtë vendit

Të nderuar,

Shpresoj që punët po u ecin mbarë.

Në lidhje me kërkesën e parashtruar nga ana KQZ-së më datë 26 gusht 2024, si më poshtë, në emër të institucionit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, sipas aprovimit të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm (ZSP), konfirmoj pajtueshmërinë dhe pëlqimin e Ministrisë për hapjen e vendvotimeve në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Kosovës sikurse të listuar në tabelën preliminare të përgatitur nga përfaqësuesit tanë. Si rrjedhojë, theksojmë gatishmërinë tonë në përmbyshjen e obligimeve tona ligjore në procesin përgatitor, organizativ dhe mbështetjes logjistike për Zgjedhjet e Përgjithshme 2025.

Krahas përcjelljes së konfirmimit mbi pajtueshmërinë për vendvotime, Ministria ka rishqyrtuar edhe njëherë hapësirat e objekteve.

Në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm vendor, të drejtën ndërkombëtare, dhe rregullimin juridik në shtetet pritëse, Ministria përmes kësaj shkrese elektronike kërkon nga KQZ të bëjë ri-vlerësim të numrit maksimal të lejuar të votuesve, me theks të veçantë në rrethet me koncentrim më të madh të diasporës. Ministria shpreh shqetësim për kufizimin në numër aq të vogël dhe konsideron që hapësirat e objekteve, kapacitetet njerëzore dhe logjistike janë parametra të arritshëm dhe të menaxhueshëm edhe në një numër më të madh të votuesve.

Ministria, në emër të ekzekutivit, propozon të rritet numri i lejueshëm në minimum të shifrave të përcaktuara si në propozim-listën e bashkangjitur.

Në listën e bashkangjitur, një ashtu, gjeni edhe komentet tona për disa nga qendrat e votimit. Ministria, për shtetin e Austrisë, propozon hapjen edhe të një qendre të votimit në qytetin e Grazit, në jug të këtij shteti.

Po ashtu, për qendrat me koncentrim më të madh të diasporës, sikurse qytetet në Gjermani, Zvicër, SHBA, Danimarkë etj., Ministria propozon dhe kërkon që KQZ të miratoj hapjen e qendrave të votimit në hapësira tjera jashtë objekteve të përfaqësive tona, mbështetur në të drejtën e aplikueshme ndërkombëtare. Meqenëse kjo është praktike e lejueshme dhe Republika e Kosovës mund të marrë në shfrytëzim hapësira që me pëlqimin e autoriteteve në shtetet pritëse mund t'i përkasin asaj në shfrytëzim për këtë proces. Për këtë, Ministria dhe përfaqësitë tona janë të gatshme që brenda afateve të parapara edhe me legjislacionet e

vendeve tjera të ndërmarrin hapat e nevojshëm për sigurimin e hapësirave sikurse edhe marrjen e pëlqimit apo/ose përcjelljen e njoftimit për organizimin e zgjedhjeve.

Ministria rritet për përkushtimin e saj për këtë proces dhe pret nga organet relevante të KQZ-së trajtimin me prioritet të kësaj kërkesë.

Me respekt,

Adenit Hoti

Zyrtar i Misionit Diplomatik – Diplomatic Mission Official

adenit.hoti@rks-gov.net | +383 38 200 77152 (office)

MPJD – MFAD

Rr. Luan Haradinaj, 10000 Prishtinë

Republika e Kosovës/RKS/

www.mfa-ks.net

From: Adenit Hoti

Sent: Wednesday, August 28, 2024 1:01 PM

To: Burim Ahmetaj <Burim.Ahmetaj@kqz-ks.org>; Kreshnik Spahiu <Kreshnik.Spahiu@kqz-ks.org>

Cc: Kreshnik Radoniqi <Kreshnik.Radoniqi@kqz-ks.org>; Ilir Muçaj <Ilir.Mucaj@rks-gov.net>; Tria Kasumi <Tria.Kasumi@rks-gov.net>; Zyra e Sekretarit në MPJD <zsp.mpjd@rks-gov.net>; Lir Krasniqi <Lir.krasniqi@kqz-ks.org>

Subject: [MPJD] Propozim-lista për qendrat e votimit/ numrin e votuesve jashtë vendit

Të nderuar,

Shpresoj që punët po u ecin mbarë.

Në lidhje me kërkesën e parashtruar nga ana KQZ-së më datë 26 gusht 2024, si më poshtë, në emër të institucionit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, sipas aprovimit të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm (ZSP), konfirmoj pajtueshmërinë dhe pëlqimin e Ministrisë për hapjen e vendvotimeve në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Kosovës sikurse të listuar në tabelën preliminare të përgatitur nga përfaqësuesit tanë. Si rrjedhojë, theksojmë gatishmërinë tonë në përmbushjen e obligimeve tona ligjore në procesin përgatitor, organizativ dhe mbështetjes logjistike për Zgjedhjet e Përgjithshme 2025.

Krahas përcjelljes së konfirmimit mbi pajtueshmërinë për vendvotime, Ministria ka ri-shqyrtuar edhe njëherë hapësirat e objekteve.

Në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm vendor, të drejtën ndërkombëtare, dhe rregullimin juridik në shtetet pritëse, Ministria përmes kësaj shkrese elektronike kërkon nga KQZ të bëjë ri-vlerësim të numrit maksimal të lejuar të votuesve, me theks të veçantë në rrethet me koncentrim më të madh të diasporës. Ministria shpreh shqetësim për kufizimin në numër aq të vogël dhe konsideron që hapësirat e objekteve, kapacitetet njerëzore dhe logjistike janë parametra të arritshëm dhe të menaxhueshëm edhe në një numër më të madh të votuesve.

Ministria, në emër të ekzekutivit, propozon të rritet numri i lejuar në minimum të shifrave të përcaktuara si në propozim-listën e bashkangjitur.

Në listën e bashkangjitur, një ashtu, gjeni edhe komentet tona për disa nga qendrat e votimit. Ministria, për shtetin e Austrisë, propozon hapjen edhe të një qendre të votimit në qytetin e Grazit, në jug të këtij shteti.

Po ashtu, për qendrat me koncentrim më të madh të diasporës, sikurse qytetet në Gjermani, Zvicër, SHBA, Danimarkë etj., Ministria propozon dhe kërkon që KQZ të miratoj hapjen e qendrave të votimit në hapësira tjera jashtë objekteve të përfaqësive tona, mbështetur në të drejtën e aplikueshme ndërkombëtare. Meqenëse kjo është praktike e lejueshme dhe Republika e Kosovës mund të marrë në shfrytëzim hapësira që me pëlqimin e autoriteteve në shtetet pritëse mund t'i përkasin asaj në shfrytëzim për këtë proces. Për këtë, Ministria dhe përfaqësitë tona janë të gatshme që brenda afateve të parapara edhe me legjislacionet e vendeve tjera të ndërmarrin hapat e nevojshëm për sigurimin e hapësirave sikurse edhe marrjen e pëlqimit apo/ose përcjelljen e njoftimit për organizimin e zgjedhjeve.

Ministria rithëkson përkushtimin e saj për këtë proces dhe pret nga organet relevante të KQZ-së trajtimin me prioritet të kësaj kërkesë.

Me respekt,

Adenit Hoti

Zyrtar i Misionit Diplomatik - Diplomatic Mission Official

adenit.hoti@rks-gov.net | +383 38 200 77152 (office)

MPJD – MFAD

Rr. Luan Haradinaj, 10000 Prishtinë

Republika e Kosovës /RKS/

www.mfa-ks.net

From: Adenit Hoti

Sent: Wednesday, August 28, 2024 5:11 PM

To: Burim Ahmetaj <Burim.Ahmetaj@kqz-ks.org>; Kreshnik Spahiu <Kreshnik.Spahiu@kqz-ks.org>

Cc: Kreshnik Radoniqi <Kreshnik.Radoniqi@kqz-ks.org>; Ilir Muçaj <Ilir.Mucaj@rks-gov.net>; Tria Kasumi <Tria.Kasumi@rks-gov.net>; Zyra e Sekretarit në MPJD <zsp.mpjd@rks-gov.net>; Lir Krasniqi <Lir.krasniqi@kqz-ks.org>

Subject: RE: [MPJD] Propozim-lista për qendrat e votimit/ numrin e votuesve jashtë vendit

Të nderuar/a,

Lidhur me propozimin e MPJD-së, mbështetur në kërkesën e Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, në interes të sqarimit më të detajuar, përcjellim informacionin si më poshtë:

Në këtë kontekst, MPJD ka përcjellë më 27 gusht sqarime të detajuara lidhur me praktikën dhe modalitetet e zbatueshme në shtete të ndryshme. Këto informacione janë pranuar nga misionet tona diplomatike të marra nga autoritetet relevante atje dhe/ose nga burime zyrtare. Informacionet e përcjella do të duhej dhe duhet të trajtohen me vëmendje nga KQZ ngase konsiderojmë se janë thelbësore për të siguruar që procesi zgjedhor të jetë i drejtë, transparent dhe në përputhje me standardet më të larta të praktikave ndërkombëtare.

Për më tepër, MPJD ka propozuar që zgjedhjet të organizohen në objekte të tjera jashtë përfaqësive diplomatike, duke marrë parasysh rregulloret dhe ligjet e vendeve pritëse. Ky propozim është i bazuar në një analizë të detajuar të legjislacionit vendor dhe të konventave që garantojnë të drejtat e qytetarëve për të votuar, pavarësisht vendndodhjes së tyre.

Ritheksojmë faktin që organizimi i zgjedhjeve në objektet e marra në shfrytëzim nga misionet diplomatike është praktikë e njohur tashmë në disa vende.

Republika e Kosovës ka mundësinë që për herë të parë të organizojë zgjedhje për shtetasit e saj jashtë vendit, përveç ambasadave dhe konsullatave, edhe në objekte të tjera duke respektuar legjislacionin e vendeve pritëse. Kjo mundësi është e rëndësishme për të siguruar një pjesëmarrje sa më masive të diasporës në proceset demokratike, veçanërisht në ato vende ku kapaciteti i kufizuar i përfaqësive diplomatike mund të pengojë qasjen e qytetarëve në votim. Mbështetur në këtë mundësi, MPJD ka propozuar rritjen e numrit në shifrat e cekura si në listën e dërguar.

Rrjedhimisht, për të siguruar që procesi zgjedhor të jetë sa më përfaqësues dhe i drejtë për të gjithë qytetarët jashtë vendit, është thelbësore që numri i personave me të drejtë për të votuar fizikisht të rritet dhe të mos kufizohet në numër simbolik. Është detyrë dhe përgjegjësi e institucioneve shtetërore që të garantojnë qasje të barabartë për të gjithë qytetarët jashtë vendit në këtë proces zgjedhor. Pra, propozimi i MPJD-së jo vetëm që forcon përfaqësimin demokratik duke i dhënë mundësi të barabarta të gjithë qytetarëve që të shfrytëzojnë të drejtën e tyre për votim, por gjithashtu kontribuon në integritetin e procesit zgjedhor.

Për të realizuar këtë, MPJD përkatësisht misionet diplomatike do të bashkëpunojë me autoritetet lokale të vendit pritës për të siguruar objekte publike, si qendrat kulturore, shkollat, apo edhe hapësira të tjera private të përshtatshme, që mund të shfrytëzohen si qendra votimi. Për këtë proces, misionet tona do t'i përfundojnë të gjitha hapat procedurale dhe administrative pranë vendeve pritëse.

Andaj, për çështjet teknike dhe logjistike që mund të lindin gjatë organizimit të zgjedhjeve jashtë përfaqësive diplomatike, MPJD është e gatshme të rregullojë të gjitha detajet me një memorandum bashkëpunimi me KQZ-në, sipas asaj që është paraparë me Rregullore. Ky memorandum do të specifikojë rolet dhe përgjegjësitë e secilës palë në mënyrë që të sigurohet një proces zgjedhor i drejtë dhe transparent.

Prandaj, MPJD mbetet e angazhuar për të ofruar mbështetjen e saj të plotë në këtë drejtim.

Me respekt,

Adenit Hoti

Zyrtar i Misionit Diplomatik – Diplomatic Mission Official

adenit.hoti@rks-gov.net | +383 38 200 77152 (office)

MPJD – MFAD

Rr. Luân Haradinaj, 10000 Prishtinë

Republika e Kosovës /RKS/

www.mfa-ks.net

From: Adenit Hoti <adenit.hoti@rks-gov.net>

Date: 28 August 2024 at 18:54:54 CEST

To: Burim Ahmetaj <Burim.Ahmetaj@kqz-ks.org>, Kreshnik Spahiu <Kreshnik.Spahiu@kqz-ks.org>

Cc: Kreshnik Radoniqi <Kreshnik.Radoniqi@kqz-ks.org>, Ilir Muçaj <Ilir.Mucaj@rks-gov.net>, Tiera Kasumi <Tiera.Kasumi@rks-gov.net>, Zyra e Sekretarit në MPJD <zsp.mpjd@rks-gov.net>, Lirik Krasniqi <Lirik.Krasniqi@kqz-ks.org>

Subject: RE: [MPJD] Propozim-lista për qendrat e votimit/ numrin e votuesve jashtë vendit

Të nderuar/a,

Duke ju falënderuar për takimin e zhvilluar pak qaste më parë, ritheksoj se MPJD qëndron në propozimin e saj për rritjen e numrit të qytetarëve jashtë vendit me të drejtë vote në formë fizike. Po ashtu, presim që KQZ të shqyrtoj po ashtu propozimin për shfrytëzimin e mundësisë për hapësirat jashtë objektit të misioneve diplomatike në vendet ku kjo është e mundshme ligjërisht.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme që KQZ të trajtoj me kujdes çështjet e ngritura duke marrë për bazë statusin diplomatik të hapësirave që shfrytëzohen nga misionet diplomatike për interes të Republikës së Kosovës, dhe duke mos ju shmangur hierarkisë ligjore të normave të të drejtës ndërkombëtare në relacion me ato ligjore.

Për fund, ashtu siç kam deklaruar edhe në takim, ju njoftoj që MPJD propozimet i ka bazuar mbi kornizën e ligjeve dhe politikave që bien në kuadrin e fushëveprimit të saj dhe jo në parametrat teknik-zgjedhor që janë në fushëveprimin e KQZ-së.

Presim nga KQZ, që pas shqyrtimit të propozimeve, të na njoftoj me shkrim për vendimet e marra nga anëtarët e respektuar të Komisionit.

Me respekt,

Adenit Hoti

Zyrtar i Misionit Diplomatik – Diplomatic Mission Official

adenit.hoti@rks-gov.net | +383 38.200.77152 (office)

MPJD – MFAD

Rr. Luan Haradinaj, 10000 Prishtinë

Republika e Kosovës-/RKS/

www.mfa-ks.net

5. Prova 5: MPJD - Propozimlista për KQZ

Shteti	Qyteti	Emri i Përfaqësës Diplomatike	
Australi	O'Malley	Ambasada e Republikës së Kosovës	13 Culgoa Circuit, 2606 O'Ma
Austri	Vjenë	Ambasada e Republikës së Kosovës	Goldeggasse 2/15, Wien 1040
Belgjikë	Brüksel	Ambasada e Republikës së Kosovës	Roger Vandendriessche 38, 11
Çeki	Pragë	Ambasada e Republikës së Kosovës	Tržiště 13, 118 00, Prague 1
Danimarkë	Kopenhage	Konsullata e Republikës së Kosovës	Frederiksholms Kanal 4 st th,
Francë	Strasbourg	Konsullata e Republikës së Kosovës	31 rue du Conseil des Quinze,
Francë	Paris	Konsullata e Republikës së Kosovës	7 Rue de Monceau, 75008 Pa
Gjermani	Düsseldorf	Konsullata e Republikës së Kosovës	Bilker Str. 29, 40215 Düsseldorf
Gjermani	München	Konsullata e Republikës së Kosovës	Albert-Schweitzer-Str. 62 81
Gjermani	Berlin	Ambasada e Republikës së Kosovës	Königsallee 20A/20B, 14193
Gjermani	Hamburg	Konsullata e Republikës së Kosovës	Rothenbaumchaussee 133, 2
Gjermani	Stuttgart	Konsullata e Republikës së Kosovës	Johannesstrasse 47/b70176 S
Gjermani	Frankfurt	Konsullata e Republikës së Kosovës	Falkensteiner Str. 77, 60322 F
Holandë	Hagë	Konsullata e Republikës së Kosovës	Koninginnegracht 44, 2514 A
Hungari	Budapest	Ambasada e Republikës së Kosovës	Budapest, Nádor utca 36, II/1
Itali	Romë	Ambasada e Republikës së Kosovës	Via Tolmino, 12, 00198 Romë
Itali	Milano	Konsullata e Republikës së Kosovës	Via San Martino, 10, 20122 M
Kanada	Ottawa	Ambasada e Republikës së Kosovës	470 Somerset St W, Ontario, I
Kanada	Toronto	Konsullata e Republikës së Kosovës	400-150 Eglinton Avenue East
Kroaci	Zagreb	Ambasada e Republikës së Kosovës	Ulica Antuna Nemčića 7/2; He
Mal i Zi	Podgoricë	Ambasada e Republikës së Kosovës	Šeik Zaid 2, The Capital Plaza,
Maqedoni e Veriut	Shkup	Ambasada e Republikës së Kosovës	Samoliov 136, 1000 Skopje,
Norvegji	Oslo	Ambasada e Republikës së Kosovës	Colbjornsens Gate 4, 0256, O
SHBA	New York	Konsullata e Republikës së Kosovës	801 2nd Avenue, Suite 301, N
SHBA	Washington	Ambasada e Republikës së Kosovës	3612 Massachusetts Ave. NW,
SHBA	Iowa	Konsullata e Republikës së Kosovës	Court Avenue 309, Suite 223,
Shqipëri	Tiranë	Ambasada e Republikës së Kosovës	Rr. Ukraina e Lirë Vila Nr.06 10
Slloveni	Lubjanë	Ambasada e Republikës së Kosovës	Tivolska cesta 48, 1000 Lubja
Suedi	Stokholm	Ambasada e Republikës së Kosovës	Birger Jarlsgatan 33, 111 45 S
Turqi	Stamboll	Konsullata e Republikës së Kosovës	Vali Konagi Cad. No 74 D-3 Nis
Turqi	Ankara	Ambasada e Republikës së Kosovës	Hirfanli Sokak 14/02 Gaziosm
UK	Londër	Ambasada e Republikës së Kosovës	8 John Street, London, WC1N
Zvicër	Bern	Ambasada e Republikës së Kosovës	Zähringerstrasse 25, 3012 Ber
Zvicër	Gjenevë	Konsullata e Republikës së Kosovës	Rue de Lausanne 63, 1202 Ge
Zvicër	Cyrih	Konsullata e Republikës së Kosovës	Eugen-Huber-Strasse 19a8048

6. Prova 6: Lista e profilit teknik të përgjithshëm të objekteve

[illegible]

7. Prova 7: Email i dërguar nga KQZ në MPJD më 26 gusht 2024

From: Burim Ahmetaj <Burim.Ahmetaj@kqz-ks.org>

Sent: Monday, August 26, 2024 5:42 PM

To: Ilir Muçaj <Ilir.Mucaj@rks-gov.net>

Cc: Kreshnik Radoniqi <Kreshnik.Radoniqi@kqz-ks.org>; Nita Mustafa <Nita.Mustafa@kqz-ks.org>; Zyra e Sekretarit në MPJD <zsp.mpjd@rks-gov.net>; Kreshnik Spahiu <Kreshnik.Spahiu@kqz-ks.org>; Lirik Krasniqi <Lirik.Krasniqi@kqz-ks.org>; Adenit Hoti <adenit.hoti@rks-gov.net>; Besnik Gecaj <besnik.gecay@rks-gov.net>

Subject: Lista e vendvotimeve në përfaqësi diplomatike

I nderuari z. Muçaj, U.D. Sekretar i Përgjithshëm në MPJD,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është në përgatitje për Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës, të cilat do të mbahen me datë 9 shkurt 2025.

Ligji për Zgjedhje të Përgjithshme parashikon votimin në përfaqësi diplomatike dhe përmes kutive postare jashtë Kosovës, procese që do të organizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD).

Para fillimit të periudhës së regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës, e cila fillon me datën 29 gusht 2024, KQZ duhet të miratoj listën e qendrave të votimit jashtë Kosovës, në mënyrë që aplikuesit përgjatë periudhës së regjistrimit të zgjedhin për qendrën e votimit jashtë Kosovës, si dhe të njoftohen për adresat e kutive postare jashtë Kosovës.

Duke u bazuar në paragrafin 8 të nenit 96 të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, KQZ në bashkëpunim me MPJD duhet të vlerësojë hapësirat fizike për secilën përfaqësi diplomatike dhe në përpithje me kriteret e përcaktuara të merr vendim për numrin e vendvotimeve dhe numrin e votuesve për secilën përfaqësi diplomatike.

Me datën 20 gusht kemi kërkuar takim për të konkretizuar çështjet e lartë cekura, pasi që në ligj theksohet se jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e shpalljes së datës së zgjedhjeve, KQZ të kërkoj nga MPJD informatat rreth përfaqësive diplomatike, ndërsa MPJD obligohet që t'i ofrojë KQZ-së të gjitha informacionet e kërkuara brenda tre (3) ditë nga dita e pranimi të kërkesës.

Sot, me datë 26 gusht 2024 kemi mbajtur takim me z. Hoti dhe z. Gecaj dhe kemi bërë vlerësimin dhe identifikimin e hapësirave të përfaqësive diplomatike.

Të bashkëngjitur gjeni dokumentin të cilin e kemi përgatitur së bashku me zyrtarët e MPJD-së, dhe përmban listën e përfaqësive diplomatike dhe numrin maksimal të votuesve në këto përfaqësi diplomatike.

Para se të bëjmë miratimin e kësaj liste dhe të fillojmë procedurën e regjistrimit, kërkojmë nga ana juaj konfirmimin se MPJD siguron hapjen e këtyre vendvotimeve në përfaqësi diplomatike dhe pajtimin për numrin maksimal të votuesve të caktuar.

Gjithashtu, para datës 29 gusht 2024 na duhet edhe lista e adresave të kutive postare jashtë Kosovës, adresat postare duhet të jenë të veçanta për votimin përmes postës, të cilat do të publikohen në sistem elektronik për informim dhe regjistrim të votuesve për votim përmes kutive postare jashtë Kosovës.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

Me respekt,

Burim AHMETAJ

Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Rr. Migjeni, nr. 21, | Prishtinë 10000, Kosovë

Tel: 038 211 152 | Mob: +38344612044

Email: burim.ahmetaj@kqz-ks.org | www.kqz-ks.org